

PLATFORMË POLITIKASH NGA TË RINJTË E KOMUNËS SË PRISHTINËS

KORRIK - SHTATOR 2017



COPYRIGHT © 2017.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 34,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PROPOZIM-PLATFORMË POLITIKASH PËR KANDIDATË PËR KRYETAR KOMUNE NË PRISHTINË ME QËLLIM TË ADRESIMIT TË ÇËSHTJEVE TË IDENTIFIKUARA SI PRIORITETE NGA GRUPI JOFORMAL I TË RINJVE

KORRIK - SHTATOR 2017





PËRMBLEDHJE

Konsolidimi dhe avancimi i qeverisjes së mirë, përveç tjerash kërkon pjesëmarrje aktive të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave publike si dhe kërkim llogaridhënies nga politikanët. Pavarësisht mundësive dhe hapësirës që ofron korniza ligjore për pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave, sidomos atyre në nivelin komunal, përvoja e deritashme ka dëshmuar që pjesëmarrja mbetet shumë e vogël dhe e kufizuar kryesisht në dy takimet e obligueshme që organizohen brenda vitit me qytetarë. Kjo pjesëmarrje reduktohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për të rinjtë, të cilët marrin pjesë në nivele pothuajse të papërfillshme të procesit të bërjes së politikave publike, e në veçanti të politikave që kanë implikime direkte në jetët e tyre.

Marrë parasysh këtë pjesëmarrje kaq të ulët të të rinjve në proceset vendimmarrëse, dhe me qëllim të nxitjes së të rinjve për pjesëmarrje aktive në proces dhe ngritjes së nivelit të përgjegjësisë nga ana e politikanëve, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është duke zbatuar projektin **“Fuqizimi i votueseve të rinjve për të marrë vendime duke qenë të informuar, dhe duke i ndihmuar**

ata që t’i mbajnë politikanët llogaridhënës.” Fillimisht, në kuadër të këtij projekti është zhvilluar një hulumtim i opinionit publik me të rinj të moshave 17 deri 21 vjeç. Të gjeturat kryesore të këtij hulumtimi tregojnë një shpërputhje mes temave të servuara në baza të politikës ditore, dhe temave që realisht preokupojnë të rinjtë. Shqetësimet kryesore të të rinjve konsistojnë në mungesën e perspektivës së punësimit, zhvillimit ekonomik, nivelin e lartë të korrupsionit, gjendjen në sektorin e shëndetësisë dhe liberalizimin e vizave. Kurse, sa i përket institucioneve më të besueshme për të rinjtë, komuna cilësohet si institucioni më i besueshëm dhe vendi i parë ku të rinjtë tentojnë të adresojnë problemet e tyre.

Mungesa e komunikimit me politikanë apo zyrtarë të partive politike është element tjetër që reflektohet në të gjeturat e hulumtimit të opinionit publik. Më konkretisht, rezultatet tregojnë se 80% e të rinjve nuk kanë komunikuar dhe nuk kanë marrë pjesë **asnjëherë** në debate me politikanë apo zyrtarë të partive politike.





Më tutje, në funksion të përmirësimit të nivelit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe rritjen e nivelit të përgjegjësisë së politikanëve, KDI ka mbajtur fillimisht shtatë (7) punëtori dy-ditore dhe katër (4) debate publike mes të rinjve dhe të zgjedhurve të tyre. Gjatë punëtorisë për llogaridhënie, rreth 200 pjesëmarrës të rinj u trajnuan lidhur me format moderne të kërkim llogaridhënies, vënien në funksion të vlerave në politikë, sistemet zgjedhore dhe të tjera.

Gjatë debateve publike, është vërejtur se shumica e shqetësimeve të të rinjve janë adresuar për nivelin lokal të qeverisjes. Për këtë arsye, por edhe me qëllim të shtrirjes së kërkim llogaridhënies edhe në nivelin lokal, KDI ka vazhduar me organizimin e punëtorive për politikën e të rinjve, që si synim parësor kanë identifikimin, priorizimin dhe ofrimin e alternativave për problemet e të rinjve. Gjatë muajve qershor dhe korrik, janë mbajtur gjithsej shtatë (7) punëtori, në komunat më të mëdha të vendit: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj dhe Gjakovë.


Grupet e të rinjve të përbërë nga studentë, ndërmar-rës të rinj, përfaqësues të grupimeve rinore të partive politike në nivel lokal, gjatë punëtorive në fjalë kanë identifikuar disa çështje apo probleme që janë të nda-rra në pesë fusha (sektorë) që bien në kompetencë të komunës. Po ashtu, janë ofruar edhe propozime për masat dhe mënyrat si do të mund të adresoheshin nga ana e autoriteteve komunale. Këto probleme dhe ofrimi i masave për zgjidhjen e tyre janë përfshirë në këtë dokument që do të ndahet edhe në formë të platformave politike për kandidatët e mundshëm për kryetar komune në zgjedhjet lokale që do të mbahen në tetor 2017, në secilën nga komunat ku janë mbajtur punëtoritë.



PROCESI I BËRJES SË POLITIKAVE NË NIVELIN LOKAL

Bazuar në ligjet e aplikueshme (Ligji për Vetëqeverisje lokale), procesi i bërjes së politikave në nivelin komunal është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës (ekzekutivi) dhe Asamblesë Komunale (legjislativi). Në praktikë, pjesa më e madhe e këtij procesi inicohet dhe derivohet nga ekzekutivi, derisa Asambleja rëndom përfshihet në proces të miratimit të politikave (vendime, rregullore) që sillen nga ekzekutivi. Përkundër faktit që me ligjet e aplikueshme komunat janë të pajisura me gamë të gjerë të kompetencave, është evidente që në shumë raste ka mungesë të buxhetit të mjaftueshëm për zbatim të projekteve të planifikuara dhe ofrim të shërbimeve të mira për qytetarët. Për pasojë, autoritetet komunale janë 'të detyruara' shumë herë të prioritojnë dhe zgjedhin çështjet dhe projektet që duhen zbatuar më parë.

Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore si dhe problemet që ballafaqojnë komunat në procesin e hartimit të buxheteve komunale, diskutimi dhe puna e grupeve të rinjve është orientuar në identifikimin e çështjeve që janë të prekshme, të zbatueshme dhe që në pjesën më të madhe nuk kanë implikime të mëdha buxhetore. Çështjet e prioritetuara dhe të propozuara në këtë dokument nuk paraqesin një listë me dëshira.





OBJEKTIVAT

JANË DY OBJEKTIVA QË SYNOHEN
TË ARRIHEN:

1

Përfshirje e drejtpërdrejt e të rinjve në procesin e bërjes së politikave publike duke ofruar propozime konkrete për çështjet që kërkojnë zgjidhje. Përfshirja e këtyre propozimeve ose jo nga ana e kandidatëve për kryetar komune në programet e tyre do t'iu shërbej të rinjve si mjet vlerësimi në marrjen e vendimeve të drejta.

2

Që të rritet komunikimi ndërmjet kandidatëve të mundshëm për zgjedhje komunale dhe qytetarëve, respektivisht të rinjve në identifikimin e problemeve dhe që diskutimet e përbashkëta me pjesëmarrje aktive qytetare të rrisin cilësinë e jetës së qytetarëve, respektivisht të rinjve.

Prioritetet e identifikuarra janë:

1

SEKTORI I RINISË



Problemet e identifikuarra:

Korniza aktuale ligjore, më konkretisht Ligji për Fuqizimin e Rinisë, dhe Strategjia për të rinjtë 2013-2017, përcakton qartë rolin dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale kundrejt krijimit të hapësirës për përfshirje të të rinjve në procesin e bërjes së politikave rinore. Strategjia për të rinjtë përcakton objektivat strategjike që synojnë përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe funksionalizimin e avancuar të sektorit të rinisë në nivelin lokal (Neni 3.1 Pjesëmarrja e të rinjve i Strategjisë së Kosovës për të rinjtë 2013-2017).

Mbështetur në këto objektiva, grupi i të rinjve ka identifikuar problemet në vijim, që lidhen me të rinjtë e Komunës së Prishtinës:

Mungesë e aktiviteteve të mjaftueshme për rininë; mungesë e përfshirjes dhe aktivizimit të të rinjve në aktivitete vullnetare; dhe në përgjithësi mungesë e orientimit dhe vullnetit tek të rinjtë për aktivizëm qytetar.

Masat e propozuara – politika të nevojshme për të adresuar këto probleme:

1 Nxitja dhe promovimi i punës vullnetare për të rinjtë duhet të adresohet dhe trajtohet si çështje me prioritet nga ana e autoriteteve komunale, të cilat nëpërmjet mekanizmave të tyre, do të mund të ishin në cilësinë e lehtësuesit të ofrimit të mundësisë për punë vullnetare. Çështja e njohjes së punës vullnetare është e rregulluar edhe me Udhëzimin Administrativ për Njohjen e punës vullnetare, i miratuar në dhjetor të vitit 2016.

Disa nga përfitimet që komuna mund t'u ofroj vullnetarëve do të ishte lirimi i plotë ose ulje për pagesat e shërbimeve komunale, bileta për kinema, teatër, transport publik, ngjarje tjera që organizohen nga komuna etj.


Qendra Rinore Sociale mund të shërbejë si koordinuese e punës vullnetare. Pas një fushate informuese, të rinjtë e interesuar do të regjistroheshin pranë Qendrës dhe të njëjtit do të pajisen me kartela identifikuese. Në anën tjetër, Komuna mund të përfitojë përmes përfshirjes së të rinjve në aktivitete të ndryshme, derisa drejtoritë e caktuara komunale mund të përgatitnin aktivitetet dhe formatin e tyre që kërkojnë angazhim vullnetar dhe më pas të koordinohen me qendrën rinore për përfshirjen e të rinjve.

Krijimi i një databaze të vullnetarëve të regjistruar do të ishte masë tjetër tejet e rëndësishme për stimulimin e të rinjve për t'u marrë me punë vullnetare. Autoritetet

komunale mund të shqyrtojnë mundësinë e dhënies së ndonjë hapësire publike (objekt që është nën menaxhimin e komunës) për të rinjtë dhe që do të mund të destinohet si lokal në të cilin do të punonin të rinjtë, apo eventualisht të merreshin me projekte të ndryshme.

2 Qendra Rinore Sociale mund të pajiset me kompetenca për koordinimin e punës dhe aktiviteteve vullnetare në komunë. E njëjta mund të udhëheqë dhe implementojë veprimet e sugjeruara më lartë.

3 Autoritetet komunale mund të përfitojnë drejtpërdrejt përmes përfshirjes së të rinjve në aktivitete të ndryshme me karakter qytetarë. Drejtoritë e caktuara komunale mund të përgatitnin aktivitetet dhe formatin e tyre që kërkojnë angazhim vullnetar dhe më pas të koordinohen me qendrën rinore për përfshirjen e të rinjve.





2

SEKTORI I ARSIMIT



Problemet e identifikuara:

Cilësia e dobët e ujit të pijes nëpër shkolla si dhe papastërtia në tualete, sidomos nëpër shkolla në fshatra, por edhe në objekte të caktuara në qytet, janë identifikuar si problem që kërkon të adresohet me prioritet nga ana e autoriteteve komunale. Mos vlerësimi i kuadrove që dalin nga shkollat profesionale nga ana e tregut të punës është një problem tjetër që duhet të trajtohet me prioritet. Një diplomë e marrë në shkollë profesionale është krejt e pamjaftueshme për të siguruar një vend pune në treg. Shumë pajisje që akoma

përdorën në shkolla janë të vjetruara dhe duhet të ndryshohen. Përkundër masave të ndërmarra nga autoritetet gjegjëse, siguria në shkolla, sidomos në ato të mesme, vazhdon të identifikohet si problem që kërkon të adresohet me prioritet. Mosrespektimi i masave të vendosura nga autoritetet komunale për çështjen e ofrimit të kurseve private nga ana e mësimitdhënësve, konsiderohet problem tjetër në fushën e arsimit që duhet të adresohet.



Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

1 Autoritetet komunale, Kryetari dhe Kuvendi Komunal, të nxjerrin vendimin për pajisje me aparate për ujë të pijshëm dhe me dezinfektues për duar në shkollat fillore dhe të mesme në gjithë Komunën. Cilësia e ujit të pijes dhe pastërtia në shkolla duhet të jenë prioritet dhe të trajtohen si meritore. Mirëmbajtja e pastërtisë në tualetet e shkollave kërkon ngritjen e përgjegjësisë së udhëheqjes së shkollave si dhe ngritje të vetëdijes së nxënësve.

2 Është e domosdoshme që tabelat e vjetra në të cilat shkruhet me shkurtesë duhet të zëvendësohen me tabela në të cilat shkruhet me marker.


3 Me qëllim të zgjidhjes së problemit të sigurisë nëpër shkolla, autoritetet komunale duhet të zbatojnë menjëherë dhe në plotëni vendimin/rregulloren e aprovuar tanimë nga komuna që rregullon këtë çështje.

4 Përkundër masave të ndërmarra nga autoritetet komunale, çështja e kurseve private që ofrohen nga mësimdhënësit vazhdon të identifikohet si problem nga të rinjtë. Jo rrallë, problemi manifestohet në procesin e notimit të nxënësve – nxënësit vlerësohen ose penalizohen varësisht nga ndjekja ose e jo e kurseve që ofrojnë mësimdhënësit e tyre. Autoritetet komunale, përmes një inspektimi më rigoroz duhet domosdoshmërisht ta adresojnë këtë dukuri problematike duke aplikuar masat ndëshkuese që janë vendosur nga vetë komuna

5 Të fuqizohen shkollat profesionale – është domosdoshmëri që të njëjtat të fuqizohen dhe kuadrot e dala të vlerësohen në treg. Disa nga mundësitë për të adresuar këtë çështje mund të jenë: rishikimi i kriterëve për praninë në gjimnaze dhe mbase rritja e kriterëve në mënyrë që cilësia të jetë kriteri i vetëm për regjistrim; po ashtu, pamundësimi i afatit të dytë për regjistrim në gjimnaze mund të konsiderohet si opsion tjetër që do të mund të nxiste shumë nxënës që të orientohen që në fillim në shkolla profesionale dhe mos t'i konsiderojnë të njëjtat vetëm si mundësi e fundit; krijimi i një ure komunikuese në mes të kuadrove nga shkollat profesionale dhe tregut të punës, respektivisht sektorit privat. Një lidhje e tillë do të mund të krijohej me vënien në funksion të një trekëndëshi – komunë – zyra për punësim – shkollat profesionale. Kuadrot evidentohen tek zyra për punësim, derisa bizneset private të kërkojnë kuadrot e nevojshme përmes zyrës.

6 Autoritetet komunale të shikojnë mundësinë e dhënies në shfrytëzim të një parcele toke të punueshme për studentët e shkollës së bujqësisë ku mund të kultivojnë perime dhe të njëjtat t'i plasojnë në treg. Kjo u mundëson ushtrimin praktik të mësimëve teorike si dhe angazhim konkret në punë.

7 Me hapjen e Kuzhinës Qendrore, autoritetet komunale mund të krijojnë mundësi për kryerjen e punës praktike për nxënës të drejtimit të hotelerisë në këtë kuzhinë. Përfitimet do të ishin të dyanshme për stafin punues në kuzhinë dhe nxënësit e përfshirë në punë praktike.





SEKTORI SOCIAL



Problemet e identifikuara:

Përkundër faktit që probleme të shumta sociale ballafaqojnë kategori të shumta të qytetarëve, grupi i të rinjve ka trajtuar në veçanti kategoritë e qytetarëve me aftësi të kufizuara si kategoritë më vulnerabël në shoqëri. Për qëllim të kësaj propozim-platfome, çështjet në vijim janë identifikuar si më urgjente që

kërkojnë veprim të menjëhershëm nga ana a autoriteteve komunale: Mungesë e konsiderueshme e infrastrukturës adekuate për qasje për personat me aftësi të kufizuara; Mungesë e kushteve dhe veprimeve për integrim më të denjë të këtyre kategorive në shoqëri.




Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

1 Vendorsja e shiritit të gjelbër nëpër pjesët kryesore të rrugëve në qytet. Varësisht nga mundësitë operuese edhe financiare, në fillim mund të vepohet në sheshet kryesore të qytetit, për të pasuar pjesët tjera që shihen të nevojshme në periudha të mëvonshme.

2 Autoritetet komunale duhet të identifikojnë të gjitha objektet shkollore, në të cilat mësojnë fëmijë me aftësi të kufizuara, që eventualisht nuk kanë pjerrina për lëvizje të karrigeve lëvizëse dhe të i vendos menjëherë. Po ashtu, sugjerohet të identifikohen të gjitha objektet publike në qytet të cilat kanë mungesë të pjerrinave dhe të njëjtat të vendosen me prioritet.

3 Autoritetet komunale duhet të trajtojnë me prioritet sigurimin e kushteve elementare për fëmijët nga këto kategori duke përfshi sigurimin e transportit nga dhe për në shkolla. Varësisht nga mundësitë financiare, autoritetet komunale të ndihmojnë edhe financiarisht organizatat gjegjëse që merren me këto kategori të qytetarëve.

4 Është e domosdoshme që autoritetet komunale të sigurojnë tekstet në alfabetin e Brail-it për kategorinë e qytetarëve që kanë nevojë.





SEKTORI I INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT



Problemet e identifikuara:

Në fushën e infrastrukturës dhe transportit, grupi i të rinjve ka identifikuar çështjet në vijim si probleme që kërkojnë të adresohen nga ana e autoriteteve komunale: Mungesë e linjave të transportit në orët e vona të mbrëmjes;

Çmimet e transportit publik për nxënës dhe studentë jo lehtë të përballueshme; Në shumë vendbanime (fshatra) fëmijët bëjnë rrugë të largët për në shkollë; Mungesë e WC-ve publike në qytet.




Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

1 Autoritetet komunale të shikojnë mundësinë për zgjatjen e orarit për autobusët urban së paku në linjat ku ka më shumë frekuentim të qytetarëve. Në rast se autoritetet kanë vendosur për zgjatjen e orarit, kërkohet që qytetarët të informohen drejtë dhe pa vonesa për planin e tillë.

2 Autoritetet komunale të shqyrtojnë mundësinë që të sigurojnë transport publik me çmim më të lirë (50%) për nxënës dhe studentë.

3 Për nxënësit e nivelit parashkollor dhe atij fillor (në vendbanimet ku nxënësit udhëtojnë më larg për tek shkollat) të ofrohet transporti nga komuna. Mund të përdoren autobusët që janë shfrytëzuar më parë në transportin publik ose, komuna mund të kontraktoj kompani private.

4 Autoritetet komunale duhet të adresojnë problemin e mungesës së tualeteve publike dhe të shqyrtojnë mundësinë e ndërtimit të tyre në zona dhe hapësira të caktuara në qytet që identifikohen të përshtatshme për diçka të tillë.





5

SEKTORI I SHËNDETËSISË



Problemet e identifikuara:

Me gjithë përmirësimin e funksionimit të qendrave të mjekësisë familjare në qytet, grupi i të rinjve ka identifikuar problemet në vijim që lidhen me nivelin e shëndetësisë primare: Mungesë e etikës profesionale nga ana e stafit në qendra të caktuara; Mungesë e shpesh të barnave

esenciale si dhe pajisjeve gjegjëse që kërkohen për kontrollim të pacientëve; Mungesë e kutive për ankesa; Mungesë e kontrollit dentar për nxënës në shkolla fillore dhe të mesme (ashtu siç ka filluar kontrolli i përgjithshëm shëndetësor).



Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

1 Kërkohet nga autoritetet komunale që të ngritin nivelin e përgjegjësisë tek punëtorët shëndetësorë në qendra të mjekësisë familjare përmes mekanizmit të inspektimit të rregullt, sidomos në zonat rurale të komunës.


2 Pavarësisht se furnizimi me barna mund të jetë kompetencë e nivelit qendror, autoritetet komunale kërkohet të adresojnë me prioritet çështjen e mungesës së barnave esenciale dhe pajisjeve tjera në qendra të mjekësisë familjare. Krijimi dhe mirëmbajtja e një databaze me të dhëna për furnizim me barna dhe materiale tjera për qendrat e mjekësisë familjare, nga ana a drejtorisë gjegjëse komunale, mund të ngrit nivelin e përgjegjësisë por edhe mund të parandalojë abuzimin e mundshëm me barna.


3 Përmes inspektimit të rregullt të qendrave nga ana e inspektorëve gjegjës, autoritetet komunale të trajtojnë problemin e mungesës së etikës profesionale që mund të shfaqet nga ana e punëtorëve shëndetësor.

4 Me qëllim të krijimit të hapësirës për qytetarët për vlerësim të paanshëm të punëtorëve dhe gjendjes në qendrat e mjekësisë familjare, kërkohet që autoritetet komunale të vendosin kuti të ankesave në të gjitha qendrat. Po ashtu, të krijohet një komision shqyrtues i këtyre ankesave (mbase në baza mujore) ku do të përfshiheshin edhe anëtarë jashtë institucioneve me qëllim të sigurimit të paanshmërisë.

5 Në rastet ku evidentohen shkelje, autoritetet të aplikojnë masat ndëshkuese sikur parashihen me normat ligjore të aplikueshme.

6 Rezultatet e mira që ka dhënë nisma për kontrollin shëndetësor të nxënësve, duhet të plotësohet edhe me kontrollin dentar të tyre. Autoritetet komunale duhet të vendosin për kontroll sistematik dentar të nxënësve. Propozohet që ky kontroll të përfshijë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme me qëllim të evidentimit të problemeve me kohë si dhe nxitjen e disiplinës shëndetësore duke qenë se akoma mungon në masë të gjerë në shoqërinë tonë.





Grupi i të rinjve që kanë kontribuar në hartimin e kësaj propozim-platforme:

AGNESA KRASNIQI

DIELLËZA RAMA

LIRIDONA SIJARINA

AGON REXHEPI

EGZON AZEMI

LORENA RUDI

ANILA MUSTAFA

ENDRIT ZABËRGJA

LUMNIJE SEFEDINI

BERITA ABAZI

ERBLINA SEJDIU

REXHEP BËRLAJOLLI

BESFORT BERISHA

ERZA KURTI

RITA SPAHIU

BLEDOR KALLECI

FJOLLA ISUFI

SHPËTIM SADIKU

BLENDË PIRA

HANUSHE HODOLLI

VIGAN SEJDIU


BRIKENA KRASNIQI

KALTRINA MISINI

BULËZA BAJRAMI

KOLOS PUKAJ





**Duke pasur parasysh kufizimet
buxhetore si dhe problemet që
ballafaqojnë komunat në procesin
e hartimit të buxheteve komunale,
diskutimi dhe puna e grupeve të të
rinjve është orientuar në identifikimin
e çështjeve që janë të prekshme,
të zbatueshme dhe që në pjesën
më të madhe nuk kanë implikime
të mëdha buxhetore.**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Projekti është mbështetur nga:



British Embassy
Pristina